Nr. 940 Prot Tiranë më 22.02.2018

VENDIM
Nr.4, datë 22.02. 2018

"Për ngritjen e grupit të punës për studimin e tregut të punës në nivel institucional të Universitetit të Tiranës "

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe bazuar në vendimin nr.24, datë 20.11.2017 të Senatit Akademik "*Për miratimin e Planit të Veprimit me qëllim përmbushjen brenda afatit të përcaktuar të të gjitha rekomandimeve të Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.62, datë 21.09.2017*", me qëllim për studimin e tregut të punës në nivel institucional të Universitetit të Tiranës , duke u mbështetur në propozimet e njësive kryesore, Senati Akademik i UT-ës në mbledhjen e datës 22.022018:

VENDOSI

1. Ngritjen e grupit të punës për studimin e tregut të punës në nivel institucional të Universitetit të Tiranës me përbërje si më poshtë :

   - Tonin Kola koordinator
   - Merita Xhumari anëtar
   - Ilir Rusi anëtar
   - Elona Dhembo anëtar
   - Erion Agolli anëtar
   - Ermal Baze anëtar
   - Eglantina Kalluci anëtar
   - Rea Kotani anëtar

2. Grupi i punës duhet të paraqesë në Rektorat Draft Raportin brenda datës 15.04.2018, i cili do të paraqitet për miratim në Senatin Akademik.

3. Çdo njësi kryesore duhet të përgatisë një studim të tregut të punës në kuadër të programeve të studimeve që ofron.

4. Grupi i punës, do të paguhet për punën e kryer sipas legjislacionit në fuqi.

5. Ky vendim i dërgohet për zbatim Zv Rektorit për anën mësimore, Administratorit të UT, Njësive Kryesore, Filialit në Sarandë, Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare, Drejtorive ndihmës akademike me karakter administrativ dhe Drejtorive administrative të Rektoratit dhe Këshillit Studentor të UT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
PROF. DR. MYNYR KONI